

VENDIM
Nr. 668, datë 19.10.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 794, DATË 22.9.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘TIRANË–ELBASAN’
(SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “ullishte” dhe “drufrutorë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 12 039 835 (dymbëdhjetë milionë e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 42 966 (dyzet e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², me vlerë 10 307 835 (dhjetë milionë e treqind e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë;

b) “ullishte”, me sipërfaqe 300 (treqind) m², me vlerë 70 800 (shtatëdhjetë mijë e tetëqind) lekë;

c) “drufrutorë”, me vlerë 1 661 200 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 12 039 835 (dymbëdhjetë milionë e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 11 600 385 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë) lekë përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

b) 439 450 (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.”.

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, për pasurinë nr. 127, zona kadastrale 1997, pasqyron në kartelën e pasurisë së paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit për interes publik të pasurisë, pronë private, dhe për sipërfaqen që mbetet “tokë bujqësore”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA PRONË PRIVATE E TË CILIT PREKET NGA DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 794, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘TIRANË–ELBASAN’
(SHTESA)”

NR. RENDOR	TË DHËNAT PËR PRONARIN					SIP. SHITESË PËR SHPRONËS. (m ²)	VLERËSIMET		VLERA	SHËNIME
	EMRI I PRONARIT	ZK	NR. I PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE		ÇMIMI (LEK/m ²)	VLERA (LEK)	TOTALE (LEK)	
1	Hysni Halit Sherifi	1997	127	Arë	2,600	935	470	439,450	439,450	Konfirmim ASHK (shpronësuar me VKM-në nr. 794, datë 22.9.2015, për sipërfaqen 1365 m ² . Referuar VKT-së nr. 57, datë 26.10.2017 dhe nr. 64/1, datë 7.07.6.2017, kërkohet për shpronësim sipërfaqja shtesë prej 935 m ²)
Vlera totale						935		439,450	439,450	

Vlerësimi për pasurinë e llojit “arë” është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.